



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Komiteti për Komunitete
Nr. 02-060/01-0023402-1/25 dt. 30.04.2025
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 39-të

Koha: 30.04.2025 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi, Habib Hajdini dhe Anesa Collaković

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot është thirrur mbledhja e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti i ZKKK për periudhën Janar-Mars 2025

Rendi i ditës u miratua unanimit

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Raportit të punës së ZKKK-së për periudhën Janar-Mars 2025 fjalën për ta sqaruar ia kaloj znj. Snezhana Nestorovic.

Snezhana Nestorovic në pika të shkurta e arsyetoi Raportin e punës së ZKK-së për periudhën Janar-Mars 2025.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani e hap për diskutim.

Anesa Collakovic: Përshëndetje, e pashë në faqen e OJQ-së që është mbajtur një trajnim në Ulcinj dhe do të doja të dija kush ka qenë i pranishëm nga Komuna jonë.

Snezhana Nestorovic: Po kam qenë unë.

Anesa Collakovic: Është e vërtetë që në faqen e OJQ-së ekzistojnë fotografi nga trajnimi i mbajtur në Ulqin, mirëpo në ato fotografi nuk shfaqet asnjë zyrtar nga Komuna jonë. Siç dihet, OJQ-të anembanë botës e kanë si praktikë të zakonshme që gjatë trajnimeve të organizuara prej tyre të bëjnë publike fotografitë dhe informatat lidhur me pjesëmarrësit.

Sipas mendimit tim, ato fotografi dhe të dhëna do të duhej të ishin pjesë përbërëse e raportit që na është dërguar, meqenëse quhet raport dhe pritet të përmbajë elemente bazë si: fotografi të pjesëmarrësve, datat e mbajtjes së aktivitetit, qëllimi i takimit, si dhe emrat e personave përgjegjës.

Me një fjalë, kjo është hera e parë që has në një raport të tillë nga një institucion në Kosovë, i cili nuk përmban informacionet themelore që do të duhej t'i kishte një raport i plotë dhe transparent.

Për këtë arsye, dua të theksoj se personalisht nuk e miratoj raportin në formën siç është dërguar.

Snezhana Nestorovic: Raporti do të bëhej shumë i gjatë, nëse përfshihen të gjitha detajet që ti ke kërkuar dhe Nuk lejohet që gjithçka të bëhet publike, ndoshta për shkak të ndonjë politike të privatësisë apo kufizimi institucional.

Anesa Collakovic: Mund të bëni konsultimi me zyrën ligjore për çështjet që mund të kenë dyshime ligjore, për të siguruar se veprimet janë të drejta dhe të ligjshme. Po ashtu kam një propozim për të bërë raportin më të qartë dhe më të strukturuar në formë tabelare dhe është një mundësi më e qartë dhe më e lehtë për t'u kuptuar. Propozimi për të shfaqur numrin e kërkesave, realizimeve dhe refuzimeve është shumë i dobishëm dhe do të mundësojë një vlerësim më të saktë dhe më të detajuar të aktiviteteve. Ne e respektojmë gjithashtu që emrat e përfituesve të mos përfshihen në raport, për të ruajtur privatësinë dhe përputhshmërinë me rregullat për mbrojtjen e të dhënave.

Agron Jashari: A ka zyra për Komunitete bashkëpunim me Agjensionin e Statistikave?

Snezhana Nestorovic: Jo nuk kemi bashkëpunim me Agjensionin e Statistikave.

Agron Jashari: Kam edhe një pyetje që ka të bëjë me riatëdhësimin, kthimi a ndodh ndaras prej zyrës së juaj sepse MPB është ka merret direk me këtë çështje.


Snezhana Nestorovic: Me këtë çështje merret vetëm MPB.


Xhafer Preteni: Propozoj që Raporti gjashtë mujor i ZKK-së të na vije i hartuar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve që i dhamë sot.

Meqenëse nuk kishte të lajmëruar të tjerë për diskutim Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budin Haziri u pajtua me propozimin e z. Preteni.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 15:45 min.

Mitrovicë
30.04.2025

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit

Jeton RRAHMANI